PSH.nr.827/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik "Marash-Shped" SH.P.K. & "Company Zuka Commerce" SH.P.K, -Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE "Pe-Vla-ku"SH.P.K.-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Lot 3" me nr. të prokurimit: 632-20-4174-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Gjakovë", më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht E bazuar ankesa e operatorëve ekonomik "Marash-Shped" SH.P.K, & "Company Zuka Commerce" SH.P.K. -Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Lot 3" me nr. të prokurimit: 632-20-4174-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Gjakovë".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Lot 3" me nr. të prokurimit: 632-20-4174-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Gjakovë", dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorëve ekonomik ankues "Marash-Shped"SH.P.K, & "Company Zuka Commerce" SH.P.K, -Gjakovë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "Marash-Shped"SH.P.K, & "Company Zuka Commerce" SH.P.K, -Gjakovë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 19.10.2020 me nr. 827/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Lot 3" me nr. të prokurimit: 632-20-4174-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Gjakovë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 6, 7, 56, 59, 61, 68 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Me gjithë se sipas ankesës nr. 827/20, OE ankues ka numëruar 6 pretendime ankimore, pas shqyrtimit dhe analizimit ankesës dhe përmbajtjes së pretendimeve ankimore, kemi vlerësuar se janë 3 pretendime ankimore në të cilat gjeni përgjigjet si më poshtë.

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Pretendimi i parë ankimorë i OE ankues sipas ankesën nr. 827/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar dëshmi për një pjesë të makinerive të kërkuara në dosje të tenderit. Më konkretisht pretendimi ankimorë shënon :"*OE* i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tij mungojnë dëshmi mbi posedimin e disa prej pajisjeve të kërkuara". Me gjithë këtë OE ankues në pretendimet e tija ankimore nuk potencon se cilat janë ato makineri/pajisje për të cilat nuk janë ofruar

dëshmitë, e po ashtu nuk potencon konkretisht se cilat janë ato dëshmi që mungojnë në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë.

Bazuar në këto që u cekën më lart konsiderojmë se pretendimi ankimorë është shumë i përgjithësuar dhe se OE ankues nuk ka pretendim ankimorë konkret se çka mungon nga oferta e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket pajisjeve, dhe si i tillë vlerësojmë se është pretendim ankimorë i pabazuar.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Pretendimi i dytë ankimorë është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit tek gjendja ekonomike financiare pika 8.1 dhe 8.2 ku është kërkuar deklarata tatimore vjetore të tatimit në të ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. OE ankues për këtë kërkesë të dosjes ka ofruar raporte bankare, për të cila konsiderojmë se nuk plotësojnë kërkesën e dosjes 8.1 dhe 8.2 ku është kërkuar decidivisht:

"Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (kopje)" Bazuar në këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar dhe se AK nuk ka respektuar kërkesat e dosje së tenderit pika 8.1 dhe 8.2. Në fund shtojmë se gjatë rivlerësimit AK konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP-së mund kërkoj informata sqaruese. Neni 39.8 I RRUOPP-së : "Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Mund te kërkohen informata sqaruese"

Përgjigje në pretendimin nr. 3

Pretendimi i tretë ankimorë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë lidhur me stafin profesional, më konkretisht OE pretendon se : "OE i shpallur fitues ka dorëzuar një listë të stafit profesional dhe të punëtorëve por në atë listë mungon Inxhinieri i Komunikacionit si dhe i mungon edhe Gjeodezi. Për këta persona OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara por nuk e ka futur fare në listën e stafit profesional ashtu siç e kishte kërkuar AK. Sipas LPP-së dhe rregullave mbi vlerësimin kjo është informatë e pa kompletuar por kur të e krahasojmë edhe me kërkesat e nenit 72 të LPP dhe 39 të RRUOPP- së, lista e stafit nuk mundet të sqarohet, atëherë kjo tregon se kërkesa e tillë nuk është plotësuar. Pas analizimit të pretendimit ankimorë, dhe krahasimit të kërkesave të dosjes së tenderit me ofertë të OE të rekomanduar për kontratë, kemi hasur në dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë (ashtu siç ka cek edhe OE ankues) ka ofruar dokumentet e kërkuara, më konkretisht ka ofruar kontrata mbi vepër me emër dhe numër për këtë aktivitet të prokurimit. Me gjithë se këta dy emra nuk gjenden në listë të stafit, (pasi që edhe nuk janë staf i rregullt i kompanisë), vlerësojmë se OE i rekomanduar për kontratë plotëson kërkesën e AK-së në dosje të tenderit, dhe vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohen apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "Marash-Shped " SH.P.K, me datë: 08.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar/a,Me date 05.11.2020 kemi pranuar ekspertizën 827/20 te ekspertit shqyrtues të OSHP-së. Ne e pranojmë mendimin përfundimtar të ekspertit që lënda të kthehet në Ri-Vlerësim por kundërshtojmë mos trajtimin si duhet të pretendimit për mungesën e dëshmive për stafin dhe pretendimin për ofrimin e çmimeve jo-normalisht të ulëta. Arsyeja pse mendojmë kështu është se nuk ika trajtuar pretendimet tona në përputhje me rregullat e LPP-së për shqyrtimin e ankesave. Trajtim jo i drejt mendojmë se është bërë tek pretendimi që lidhet me mënyrën se si e ka paraqitur stafin OE i shpallur fitues. Sipas rregullave te prokurimit publik kur listat e dorëzuara p.sh për projektet e realizuara, stafit, makinerive etj. nuk e plotësojnë kushtin e kërkuar nga AK, atëherë OE duhet refuzuar. Këtë nuk e ka marrë për bazë eksperti. Ne kemi pretenduar edhe se OE i shpallur fitues ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta mirëpo eksperti shqyrtues e ka anashkalua duke mos e trajtuar fare këtë pretendim të shkeljes së nenit 61 të LPP-së dhe shkelje edhe të rregullores B57 të KRPP-së. Ne mendojmë edhe se si pretendim e ka futur gabimisht pretendimin për pajisjet qe gabimisht ka mbetur tek elaborimi i shkeljes së nenit 6 të LPP-së po që shihet se nuk lidhet me pajisjet e qe shihet qartë se ka mbetur gabimisht në material nga një ankesë e mëhershme. Bazuar në krejt sqarimin e mësipërm mendojmë se pretendimi për mungesën e ofrimit të dëshmive për stafin nuk është trajtuar drejt ndërsa pretendimi për çmimet jo-normalisht të ulëta nuk është trajtuar fare. Ne kërkojmë që Paneli Shqyrtues që gjatë seancës dëgjimore ta trajtoj pretendimin për stafin edhe një here dhe ta trajtoj pretendimin për çmimet jo-normalisht të ulëta ashtu siç e kemi paraqitur edhe ne ankese tek përshkrimi i shkeljes së nenit 61 të LPP-së dhe rregullores B57 që eksperti nuk e ka trajtuar fare. E lusim panelin shqyrtues që pas këtij trajtimi ta aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lëndën ta kthej në ri-vlerësim. Ne mbetemi me shpresë për një përgjigje pozitive nga ana e Panelit Shqyrtues. Sinqerisht Marash Shped SH.P.K.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e

dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendimi i parë ankimor i OE ankues sipas ankesën nr. 827/20 është se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar dëshmi për një pjesë të makinerive të kërkuara në dosje të tenderit. Më konkretisht pretendimi ankimor është: "*OE* i shpallur fitues nuk është i përgjegjshëm pasi që në ofertën e tij mungojnë dëshmi mbi posedimin e disa prej pajisjeve të kërkuara". Me gjithë këtë OE ankues në pretendimet e tija ankimore nuk potencon se cilat janë ato makineri/pajisje për të cilat nuk janë ofruar dëshmitë, e po ashtu nuk potencon konkretisht se cilat janë ato dëshmi që mungojnë në ofertë të OE të rekomanduar për kontratë.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor është shumë i përgjithësuar dhe se OE ankues nuk ka pretendim ankimor konkret se çka mungon nga oferta e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket pajisjeve, dhe si i tillë është pretendim ankimor i pa bazuar.

Pretendimi i dytë ankimor është se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit tek gjendja ekonomike financiare pika 8.1 dhe 8.2, ku është kërkuar deklarata tatimore vjetore të tatimit në të ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE për këtë kërkesë të dosjes ka ofruar raporte bankare, për të cila konsiderojmë se nuk plotësojnë kërkesën e dosjes 8.1 dhe 8.2, ku është kërkuar decidivisht: "Deklaratat Tatimore Vjetore të Tatimit në të Ardhura ose Korporata të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (kopje)". Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar dhe se AK nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit pika 8.1 dhe 8.2. Në fund shtojmë se gjatë rivlerësimit AK konform nenit 59 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP-së mund kërkoj informata sqaruese. Neni 39.8 i RRUOPP-së: "Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Mund te kërkohen informata sqaruese"

Pretendimi i tretë ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë lidhur me stafin profesional, më konkretisht OE pretendon se: "OE i shpallur fitues ka dorëzuar një listë të stafit profesional dhe të punëtorëve por në atë listë mungon Inxhinieri i Komunikacionit si dhe i mungon edhe Gjeodezi. Për këta persona OE ka dorëzuar dëshmitë e kërkuara por nuk e ka futur fare në listën e stafit profesional ashtu siç e kishte kërkuar AK. Sipas LPP-së dhe rregullave mbi vlerësimin kjo është informatë e pa kompletuar por kur të e krahasojmë edhe me kërkesat e nenit 72 të LPP dhe 39 të RRUOPP- së, lista e stafit nuk mundet të sqarohet, atëherë kjo tregon se kërkesa e tillë nuk është plotësuar. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të pretendimit ankimor dhe krahasimit të kërkesave të dosjes së tenderit

me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, janë hasur dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë (ashtu siç ka cek edhe OE ankues) ka ofruar dokumentet e kërkuara, më konkretisht ka ofruar kontrata mbi vepër me emër dhe numër për këtë aktivitet të prokurimit. Me gjithë se këta dy emra nuk gjenden në listë të stafit, (pasi që edhe nuk janë staf i rregullt i kompanisë). Andaj, OE i rekomanduar për kontratë plotëson kërkesën e AK-së në dosje të tenderit dhe pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësimin e ofertave sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të bëjë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 "KK Gjakovë";

1x1 OE "Marash-Shped & Company Zuka Commerce" SH.P.K-Gjakovë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.